



SHOQATA E PRODHUESVE
TË QUMËSHITIT TË KOSOVËS

KOSOVO ASSOCIATION OF
MILK PRODUCERS KAMP



Kingdom of the Netherlands

"Commissioned by the Netherlands Enterprise
Agency and funded by the Ministry of Foreign Affairs"

MENAGJIMI DHE TË USHQYERIT E LOPËVE



AERES
UNIVERSITY OF
APPLIED SCIENCES
DRONTEN

HYRJE	4
LËNDËT USHQYESE	4
Uji	4
Lënda e thatë (LTH)	5
Proteinat	5
Karbohidratet/energja	6
Yndyrat	6
Mineralet	7
Vitaminat	7
Përbërja e lëndëve ushqyese	7
Ushqimet voluminoze	8
Bërsia e birrës (e lagur)	9
Ushqimet energjetike	9
Elbi	9
Thekri	10
Gruri	10
Himet e grurit	11
Rriskat e pangjarsheqerit	11
Jongja e palëtuar	11
Bërsia e sojës	12
Bërsia e lule diellit	12
KËRKESAT PËR LËNDË USHQYESE	12
Faza e parë	12
Faza e dytë	13
Faza e tretë	14
Faza e katërt	14
KOHA E PERIUDHËS SË THARJES	15
Ndërrimi i ushqimit	15
Rregullat e ushqimit	16
SI TË PARANDALOJMË STRESIN TEK LOPËT PARA DHE PAS PJELLJES	16
Çka nënkuptojmë lopët pa stres në kohën e pjelljes?	16
Pse lopët duhet të jenë pa stres në kohën e pjelljes?	16
Cilat janë hapat që duhet ndërmarrë në mënyrë që lopët të jenë të lira nga stresi?	16
Çka ju duhet?	16
VLERSIMI I RUMENTI	16

Shkalla 1	16
Shkalla 2	16
Shkalla 3	17
Shkalla 4	17
Shkalla 5	17
A SHFRYTËZOHET I GJITHË RACIONI?	18
Shkalla 1	18
Shkalla 2	19
Shkalla 3	19
Shkalla 4	19
Shkalla 5	19
VLERËSIMI I BAJGËS ME ANË TË PREKJES DHE DUKJES	20
Shkalla 1	20
Shkalla 2	20
Shkalla 3	20
Shkalla 4	21
Shkalla 5	21

HYRJE

Të ushqyerit e kafshëve ka ndikim të madh në profitabilitetin e fermave për prodhimin e qumështit. Për të pasur një prodhimtari optimale të qumështit, racionet duhet të jenë mirë të balancuara. Me sigurimin e sasisë dhe cilësisë së ushqimit lopët qumështore mund të prodhojnë qumësht në bazë të kapacitetit gjenetik që kanë, dhe të mbajnë mirë shëndetin e tyre. Racioni duhet të plotësojë kërkesat në energji dhe proteina, për mirëmbajtje, prodhim të qumështit, rritje dhe riprodhim. Një racion komplet duhet të plotësojë kërkesat me sasi adekuate të mineraleve dhe vitaminave.

Lloji i ushqimeve, përbërja e tyre dhe kërkesat ushqyese të lopëve qumështore dallojnë në masë të madhe në vende të ndryshme. Ndikimi i faktorëve të jashtëm si klima kanë ndikim në prodhimin e qumështit dhe shfrytëzimin e potencialit gjenetik të lopëve. Për këtë arsye është shumë e vështirë të jepen rekomandime të përgjithshme dhe të zbatueshme për të gjitha rrethanat.

Racioni duhet të përmbajë ushqime voluminoze për tretje optimale në rumen dhe në përbërjen e qumështit. Sasia e ushqimeve fibroze në racion duhet të jetë së paku një e treta e materies së thatë totale ditore për të parandaluar çrregullimet digjестive. Prandaj, ushqimet e thata sikurse llojet e ndryshme të sanës, barit dhe silazhe të misrit duhet të formojnë bazën e një racioni të mirë. Po ashtu racioni duhet të jetë i shijshëm dhe tërheqës për lopën.

Kostoja e të ushqyerit duhet të mbahet e ulët për të arritur profitabilitetin në fermë. Prandaj, maksimizoni përdorimin e ushqimeve të thata kualitative dhe në disa raste drithërat. Përzierje shtesë koncentratit me sasi adekuate të mineraleve dhe vitaminave duhet të përdoren për të balancuar prodhimin optimal të qumështit me koston më të ulët të mundshme për njësi të proteinave ose energjisë.

LËNDËT USHQYSE

Në mënyrë që të kemi njohuri më të mira për të ushqyerit e kafshëve duhet së pari të kemi njohuri sa i përket lëndëve ushqyese, përqindjen e tyre, ndarjen e ushqimeve në grupe dhe se si kontribuojnë ato në të ushqyerit e kafshëve.

UJI

Uji është një komponent esencial i racioneve ditore për lopët qumështore pasi që trupi i kafshës përmban rreth 55-60% të peshës së gjallë. Uji është i nevojshëm për mirëmbajtjen dhe nivelin e lëngjeve trupore, tretjen e materieve ushqyese, prodhimin e qumështit. Përveç kësaj marrja e ujit varet nga lënda e thatë e përmbajtjes së ushqimeve nga prodhimi i qumështit dhe kushteve klimatike

Ushqimet foragjere kanë sasi më të madhe të ujit në raport me lëndën e thatë, ndërsa drithërat dhe produktet e tyre përmbajnë relativisht sasi të ulët të ujit. Uji gjithmonë duhet të jetë i freskët dhe në dispozicion të përhershëm. Kërkesat për ujë të lopët qumështore llogariten në bazë të prodhimit të qumështit. Për një litër qumësht të prodhuar nevojiten rreth 3 deri 5 litra ujë në ditë. Është me rëndësi që ujë pirësja të jetë e pastër dhe se valvula të japë mbi 20 litra ujë në minutë

Lënda e thatë (LTH)

Lënda e thatë është lëndë e cila mbetet pasi uji është larguar nga ushqimi. Kërkesat për lëndë të thatë për lopët me prodhimtari të lartë të qumështit është 3-4% masës trupore. Lopët e kanë të rregulluar konsumimin lëndës së thatë dhe ujit në mënyrë të pavarur. Konsumimi i lëndës së thatë varet njëra prej tjetrës, përqindjes së lëndës së thatë në racion, prodhimit të qumështit dhe klimës. Lënda e thatë mund të ndahet në materie organike dhe inorganike. Materiet organike përmbajnë lëndët ushqyese si proteina, yndyrat, karbohidratet dhe vitaminat. Materiet inorganike përmbajnë mikro dhe makro mineralet.

Tabela 4. Faktorët të cilët ndikojnë në konsumimin e lëndës së thatë

Faktorë të kafshëve	Faktorë të kafshëve
Prodhimtaria e qumështit	Kualiteti/përqindja e lëndës së thatë
Mundësia e konsumimit	Tretshmëria
Pesha	Përmbajtja e proteinave të përgjithshme
Rritja	Përmbajtja e celulozës
Periudha e laktacionit	Përmbajtja e yndyrës
Koha e mbarrsmërisë	Vlera energjetike
Mosha dhe shëndeti	Kualiteti i silazhes (era)
Kushtet e përgjithshme	Struktura e ushqimit

Proteinat

Sigurimi i proteinave në racion është i rëndësishëm për mirëmbajtje dhe prodhimtari normale të organizmit të kafshës. Proteinat e marra në racion duhet gjithmonë të jenë të balancuara në bazë të kërkesave të lopëve qumështore.

Gjithashtu duhet bërë dallimin e proteinave të degraduara dhe të pa degraduara. Cili është dallimi dhe rëndësia e këtyre proteinave: Proteinat e degraduar janë proteina të cilat zbërthehen apo treten në rumenin e lopës. Ndërsa sa i përket proteinës së pa degraduar një pjesë e tyre kalojnë rumenin dhe zbërthehen apo treten në zorrët e holla. Lopët me prodhimtari të lartë të qumështit kanë nevojë substanciale për sigurimin e proteinave të cilat treten në zorrët e holla apo siç quhen proteina të pa degradura.

Tabela 5. Lista e ushqimeve me proteina të padegraduara në rumen

Ushqimet	% e proteinave të padegraduara	Ushqimet	% e proteinave të padegraduara
Jongja e palëtuar	59	Pangjar sheqeri	45
Mielli I gjakut	82	Jongja e freskët	28
Treberi I thatë	49	Elbi	27
Misëri	52	Silazhi I misrit	31
Mielli I peshkut	60	Silazhi I barit	29
Kullosa e freskët	40	Tërshëra	17
Bërsia e sojë	26	Himet e grurit	29
Bërsia e lulediellit	26	Melasa e pangjarsheqerit	35

Karbohidratet/energji

Ushqimet për lopët qumështore gjithmonë duhet të përmbajnë energjinë në nivelin e duhur. Burime të energjisë janë: të gjitha llojet e drithërave, silazhi i misrit etj. Në periudhën e laktacionit, mungesa e energjisë shkakton humbje të peshës trupore dhe ulje të prodhimtarisë së qumështit. Mungesa e energjisë po ashtu pengon: rritjen dhe zhvillimin normal të kafshës, pjekjen e qelizave dhe ovulacionin (rritja dhe lirim i vezëve tek lopët është i dobët apo ndalet) dhe afshi seksual është i vonuar dhe i pa dukshëm.

Efektet e energjisë së tepërt në racion janë zakonisht evidente kur në fermë kemi shumë lopë të trashura se tepërmi. Kjo zakonisht ndodh kur në racion përdorim për një kohë të gjatë vetëm sasi të tepërta të drithërave dhe silazh të misrit. Gjithashtu, lopët trashen së tepërmi kur në racion kemi mungesë të proteinave, në këtë mënyrë lopët nuk mund të arrijnë prodhimtarin maksimale të qumështit.

Lopët që janë shumë të trasha gjatë pjelljeve janë të prira të kenë lindje të vështira, mbetje të placentës, zhvendosje të abomazusit etj.

Yndyrat

Kanë përmbajtjen më të lartë energjike për njësi matëse. Janë burime kryesore të rezervave energjike për kafshët. Racionet ushqimore duhet të kenë acide yndyrore të pangopura të cilat garantojnë prodhimtari të lartë të qumështit dhe fertilitetit të mirë. Racioni që përmban 50 gram yndyra bimore për kilogram të lëndës së thatë për lopët e sapo pjella dhe 40 gram për kilogram të lëndës së thatë për lopët në fund të laktacionit zakonisht plotëson këto kërkesa.

Ushqimet voluminoze në përgjithësi kanë pak yndyrë, me përjashtim bari i njomë (kullosat e freskëta) të cilat janë burim i rëndësishëm i acideve yndyrore esenciale. Koncentratet e përziera kanë përmbajtje më të madhe të yndyrave, për këtë arsye



duhet të kemi kujdes në sasinë e të ushqyerit me koncentrat. Sasia e madhe e koncentratit në racion mund të rrisë sasinë e acideve yndyrore në rumen dhe si pasojë zvogëlohet fermentimi i celulozës në rumen.

Mineralet

Janë të nevojshme për fuqizimin e skeletit dhe për të gjitha funksionet vitale. Mineralet mund të ndahen në dy grupe makro dhe mikro mineralet.

Kërkesat me të mëdha janë për makro minerale si: Natriumi (Na), Klori (Cl), Kalciumi (Ca), Fosfori (P), Kaliumi (K), Magneziumi (Mg), Sulfuri (S).

Vitaminat

Janë të tretshme në yndyra ose të tretshme në ujë. Vitaminat të cilat treten në yndyra (A, D, E, K) janë të nevojshme për funksionimin normal të disa indeve specifike tek lopët.

Vitaminat të cilat treten në ujë (B dhe C) veprojnë si përbërës ose si aktivatorë të enzimave në nivel biokimik. Vitaminat në sasi të vogla janë esenciale për shëndetin e përgjithshëm, mirëmbajtjen e strukturës së trupit, prodhimit të qumështit, rritjes dhe riprodhimit. Vitamina A dhe D janë dy vitamina të vetme të cilat nuk mund të prodhohen nga vet kafshët, dhe duhet të plotësohen në racion ushqimor.

Përbërja e lëndëve ushqyese

Përbërja e lëndëve ushqyese varet nga shumë faktorë. Kjo përfshinë kualitetin dhe shkallen e plehërimit të tokës, kohën e korrjes apo kullotjes dhe kushteve klimatike. Mesatarja e përbërjes së disa ushqimeve të freskëta është e paraqitur në tabelën 6 dhe 7. Këto tabela paraqesin një udhëzues praktik në balancimin e racioneve.

Tabela 6. Shembuj të ushqimeve voluminoze dhe përbërja e tyre ushqyese për kg të produkteve të freskëta (g/kg)

Lloji i Ushqimit	L.Th g	Cel. g	TDN g	NEL Mcal	Pro g	Ca g	P g	Mak kg/rac.
Jonxha e freskët	200	50	120	0.30	45	4.4	0.7	
Bërsia e birrës/lagur	220	30	150	0.35	55	0.6	1.2	10
Silazhi I barit	450	100	280	0.60	75	2.5	1.0	
Silazhi I misrit	300	75	180	0.35	20	0.8	0.7	
Jonxha e tharë	900	200	540	1.30	200	13.4	3.0	
Jonxha e palëtuar	920	240	550	1.25	175	14	2.3	
Kashta e elbit	910	380	430	0.9	40	2.7	0.7	
Kashta e tërshërës	920	375	460	1.05	40	2.2	0.6	
Kashta e grurit	900	375	400	0.85	30	1.6	0.5	
Talla e misrit	850	300	510	1.15	50	4.9	0.8	

Tabela 7. Shembuj të ushqimeve të pasura me energji dhe proteina dhe përbërja e ushqimeve në kg të ushqimeve të freskëta (g/kg)

Lloji i Ushqimit	L.Th g	Cel. g	TDN g	NEL Mcal	Prot g	Ca g	P g	% /konc
Elbi	900	50	750	1.8	115	0.5	3.4	70
Misri	900	20	800	1.8	95	0.5	2.8	50
Tërshëra	900	105	690	1.55	120	0.8	3.4	25
Himet e grurit	900	100	630	1.4	155	1.3	11.6	25
Riskrat e pangjarsheqerit	900	160	700	1.55	90	5.6	0.9	15/rac
Bërësia e birrës	920	130	650	1.5	275	3	5	10
Bërsia e sojë	900	60	760	1.65	440	3.5	6.4	
Bërsia e lulediellit	920	110	700	1.6	450	3.8	10	20

Ushqimet voluminoze

Ushqimet voluminoze kualitative janë burim shumë i mirë i celulozës për funksionimin optimal të rumenit. Kjo ka të bëjë me ndikimin e florës në rumen. Me qëllim të përgatitjes dhe rritjes së vlerave ushqyese të ushqimeve voluminoze

është shumë me rendësi që të kositen apo kulloten në kohën optimale para fazës së pjekjes së bimëve. Përafërsisht vlera ushqyese e të gjitha ushqimeve voluminoze është më e lartë në kohën para lulëzimit. Vlerat ushqyese dhe tretshmëria e tyre zvogëlohen pas kësaj kohe. Misri, për t'u silazhuar duhet të korret në pjekurin dyllore, që kokrra e misrit të marre vlera më të larta ushqyese

Bërsia e birrës (e lagur)

Është nënprodukt i industrisë së birrës. Është ushqim me proteinë dhe energji mesatare. Është shumë i shijshëm dhe më së miri është ta japim në ushqim 5-10 kilogram në ditë për lopët qumështore. Duhet të jepet i freskët ose të përdoret nga depozitimi i silazhuar. Nëse silazhohet bërsia e birrës së njomë duhet 4- 6 jave për tu fermentuar. Është me rendësi se vendi ku bëhet silazhi të ketë drenazhim të mirë në mënyrë që masa e silazhuar mos të priset.

Ushqimet energjetike

Drithërat kanë përmbajtje të lartë energjike dhe përqindje të ulët të proteinave. Në tabelën 7 janë të paraqitur sasia maksimale që mund të përdoren në përgatitje e koncentratit.

Elbi

Elbi duhet të bluhet, ose të grimcohet pak për përdorim maksimal për lopët qumështore, përndryshe nëse nuk bluhet elbi do të kalojë nëpërmjet traktit tretës pjesërisht i pa tretur. Ka rreth 95% të vlerës energjike të misrit dhe është ushqim shumë i shijshëm dhe ideal për gjedhe. Përqindja mesatare e proteinave është rreth 12 %. Nëse përdoret në sasi të madhe mund të shkaktoj probleme si acidoz të lartë në rumen.

Nuk rekomandohet që ushqimet e koncentruara të keme më shumë se 50 % elb.



Misri

Misri është ushqim shumë i shijshëm dhe plotëson kërkesat më të mëdha për energji. Sidoqoftë misri ka përqindje të ulët të proteinave, fibra të ashpra dhe minerale. Misri mund të përdoret si burim kryesor i energjisë. Me qëllim të shfrytëzimit sa më të mirë të energjisë duhet të balancohet në mënyrë të duhur me ushqimet tjera ne racion. Duhet të përdoret i bluar ose i thyer apo kafshët mund të



ushqehen duke e silazhuar misrin kokërr me përqindje të lartë të lagështisë. Misri i bluar nuk duhet të ruhet shumë gjatë për shkak se shumë lehtë prishet dhe i ulet vlera ushqyese.

Tërshëra

Tërshëra është shumë e pasur me celulozë, prandaj rekomandohet përzjerja e tërshërës me drithëra të tjera ne forme të bluar për shfrytëzim maksimal. Tërshëra ka efekt pozitiv në prodhimin e qumështit dhe yndyrës së qumështit. Tërshëra në formë të thyer është ushqim shumë i mirë për viçat. Përmbajtja e lartë e celulozës kontribuon në zhvillimin e hershëm të rumenit te viçat. Në ushqimet e koncentruara rekomandohet të përdoret deri ne 15% për lopët qumështore.



Thekri

Thekri është i pasur me energji dhe minerale. Përqindja e proteinave te thekri është rreth 11.6 %. Në ushqimet e koncentruara për lopë qumështore rekomandohet të përdoret deri në 25 % ndërsa te viçat deri në 10 %.

Gruri

Gruri është i pasur me energji, ndërsa përqindja mesatare e proteinave është rreth 13 %, amidon 64 %, ka pak fibra. Gruri ka sasi të lartë të glutenit, dhe nëse përdoret i bluar shumë hollë mund të shkaktoj problem në tretje. Karbohidratet letë të fermentueshme të cilat posedon gruri mund të shkaktojnë acidoz të rumenit nëse përdoren në sasi të madhe në racion. Rekomandohet që përqindja e grurit në ushqimet e koncentruar për lopët qumështore të jetë 40 %, ndërsa te viçat deri në 25 %.

Himet e grurit

Është nënprodukt industrisë së miellit të grurit, dhe është ushqim shumë i shijshëm. Është i varfër në kalcium por është i pasur me fosfor më shumë se drithërat e tjerë dhe nënproduktet e tyre. Himet e grurit janë të pasura me celulozë dhe kanë efekt laksativ. Himet e grurit përmbajnë deri 17 % proteina. Në ushqimet e koncentruara për lopë rekomandohet të përdoret deri në 20 % ndërsa për viça deri në 10 %

Rriskat e panxharsheqerit

Rriskat panxharsheqerit të thata zakonisht gjenden në formë të peletuar. Janë burim i mirë i energjisë për lopët qumështore që prodhojnë sasi të lartë të qumështit. Po ashtu kanë përqindje të lartë të proteinave (45 % e proteinave) të cilat nuk tretën në rumen apo proteinave të padegraduara. Fibrat e ashpra janë shumë të tretshme, për këtë arsye rrishtat e panxharsheqerit mund të shtohen në racion deri në 3 kilogram në ditë. Përmbajnë rreth 11 % proteina. Në ushqimet e koncentruara për lopë mund të përdoret deri në 30 %, ndërsa për viçat deri në 20 %.

Jonxha e palëtuar

Jonxha e palëtuar prodhohet me dehidratimin (tharjen) e jonxhës. Proteina e jonxhës sëpalëtuar është më pak e degraduar në rumen se sa proteina e jonxhës së thatë, kështu që jonxha e palëtuar është burim i mirë i proteinave të padegraduara apo proteinave të cilat treten në zorrë të holla.

Bërsia e birrës e thatë

Proteina e bërsisë së birrës së thatë degradohet relativisht në masë të vogël në rumen. Lopët qumështore mund të ushqehen deri në 2 kilogram në ditë. Ajo përmban rreth 49% të proteinave të padegraduara në rumen.

Soja

Soja është e pasur me proteina, vaj dhe energji. Soja duhet të bluhet, ose të shtypet dhe nuk duhet të ruhet me gjatë se një javë. Soja e bluar ose e shtypur shpejt prishet për shkak të përmbajtjes së lipazës. Gjithashtu soja përmban enzimën e quajtur ureza, e cila e shndërron urenë në amoniak dhe mund të ketë efekte negative në sistemin e tretjes të lopës.



Lipaza dhe ureaza inaktivizohen apo shkatërrohen me nxehtësi.

Lopët qumështore të cilat ushqehen me sojë të përpunuar në nxehtësi prodhojnë më shumë qumësht se sa lopët që ushqehen me sojë të papërpunuar. Për këtë arsye rekomandohet të përdoret berisa e sojes në racionet ushimore të kafshëve.

Bërsia e sojës

Bërsia e sojës është një ndër burimet më të pasura me proteina dhe energji bimore. Është ushqim shumë i shijshëm dhe mund të përdoret si burim kryesor i proteinave në racionet ditore. Varësisht nga kualitetit, bërsia e sojës përmban 45 – 55 % proteina. Në ushqimet e koncentruara për lopë qumështore rekomandohet të përdoret deri në 35 %.

Bërsia e lule diellit

Bërsia e lule diellit është nën produkt i mbetur pasi vaji është nxjerrë nga farat e lule diellit. Përbërja e lëndëve ushqyese ndryshon varësisht nga prezenca lëvizëse apo celulozës. Përqindja e proteinave është rreth 36 %. Në ushqimet e koncentruara për lopë qumështore rekomandohet të përdoret deri në 25 %.

KERKESAT PËR LËNDË USHQYESE

Kërkesat për lëndë ushqyese dhe niveli i konsumit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme gjatë fazës së laktacionit të lopës. Konsumi ditor i lëndës së thatë dhe kërkesat për prodhim të qumështit nuk janë gjithmonë në balancë nga pikëpamja e kërkesave ushqimore, pra periudha e laktacionit duhet të ndahet në katër faza.

Faza e parë

Zakonisht lopët janë në kulmin e dhënies së qumështit në mes ditëve 30 dhe 40 pas pjelljes, gjersa marrja e lëndës së thatë ditore arrin kulmin e konsumimit në mes ditëve 60-80. Prej kohës së pjelljes deri te arritja e kulmit të prodhimtarisë së qumështit, një lopë me prodhimtari të lartë është në periudhën e saj më të vështirë për të plotësuar nevojat ushqimore, veçanërisht për energji dhe proteina. Mungesa apo vonesat në konsumimin e lëndës së thatë në krahasim me prodhimtarinë e qumështit rezultojnë me mungesë të energjisë dhe mund të shkaktojnë humbjen e peshës trupore gjatë fazës së parë të laktacionit. Shpesh, pas 90 ditëve, konsumimi i lëndës së thatë është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat për energji përveç atyre kafshëve të cilat kanë prodhimtari të lartë të qumështit dhe atyre të cilat kanë humbur shumë kondicionin trupor.

Racionet ushqimore të pasura me celulozë ndihmojnë në parandalimin e çrregullimeve metabolike, siç është acidoza e rumenit. Racionet ushqimore nuk duhet të përmbajnë më pak se 16% të lëndës së thatë të fibrave në racionet ushqimore. Gjatë periudhës së parë, lopët me prodhimtari të lartë të qumështit duhet të ushqehen me ushqim voluminoz të kualitetit të lartë me një vlerë të lartë të energjisë, së bashku me një sasi të koncentratit i cili degradohet ngadalë në rumen

Një racion me energji të tillë të lartë do të ndihmojë të reduktojë humbjen e peshës trupore. Amidoni mund të ketë efekt pozitiv në prodhimin e qumështit dhe përqindjes së proteinave por mund të ketë efekt në uljen e yndyrës së qumështit. Amidoni nga patatet dhe drithërat (i degraduar lehtësisht) është i njohur për uljen e yndyrës së



qumështit dhe për faktin se sasi të mëdha të këtyre ushqimeve në racion mund të shkaktojnë acidozën e rumenit. Kjo zakonisht ndodhë më shpesh te lopët në laktacion të hershëm kur ndryshimet bëhen në racione që përmbajnë sasi më të larta të drithërave sesa ushqimet gjatë periudhës së tharjes. Si problem kryesor i kësaj mund të shkaktohet zhvendosja e abomazutit.

Përzjerja ditore e të gjithë përbërësve për të fituar racion homogjen ka avantazh ndaj të ushqyerit me sasi më të mëdha të përbërësve individual. Rekomandohet të plotësohen racionet me sasi të mjaftueshme të mineraleve dhe vitaminave për të mënjeluar mungesat gjatë kësaj faze.

Faza e dytë

Në mes ditëve 90 - 200, marrja e lëndës së thatë është e mjaftueshme për nevojat e energjisë për prodhim të qumështit dhe rritje. Lopa qumështore rifiton peshën e humbur trupore gjatë fazës së parë. Racionet e pasura me energji kanë efekt më të vogël në prodhimin e qumështit sesa në periudhën e parë. Duhet të kemi kujdes në dhënien e ushqimeve të pasura me energji (misër), sepse ekziston rreziku i trashjes së tepërt të lopëve nga fundi i laktacionit.

Faza e tretë

Nga dita e 200 e më lartë prodhimi i qumështit bie akoma dhe konsumimi i lëndës se thatë në ditë vazhdon të mbetet e lartë, që rezulton me marrje të tepërt të energjisë mbi kërkesat. Gjatë kësaj periudhe, lopët në prodhimtarinë e qumështit duhet të ushqehen me racion me energji me të ulët për të parandaluar sindromën e trashjes së lopës. Pastaj është e këshillueshme të largohen fare ushqimet me energji të lartë, sikurse është misri, silazhi i misrit etj. Është e rekomandueshme që lopët të ushqehen me racione me sasi të mëdha të ushqimeve voluminoze dhe me ushqime me përmbajtje të vogël të karbohidrateve të degraduara lehtësisht.



Faza e katërt

Periudha e katërt konsiston në periudhën e tharjes, në këtë fazë lopët duhet të ushqehen me racione të cilat janë me sasi të ulët të energjisë por me sasi të mjaftueshme të mineraleve dhe vitaminave, e cila redukton rrezikun e mbi-trashjes. Racione të tilla parandalojnë vështirësitë në pjellje dhe çrregullimet metabolike, si pareza e qumështit, ketozës dhe sindromën e lopëve të trasha. Gjatë muajit të parë të periudhës së tharjes,



lopët duhet të ushqehen sipas standardeve për mirëmbajtje dhe prodhim të qumështit të 2-4 kg. Gjatë muajit të dytë të periudhës së tharjes lopëve duhet t'u jepen racione për plotësimin e kërkesave për prodhimin e qumështit prej 5-7 kg. Këto kërkesa mund të adaptohen në bazë të kondicionit trupor të lopës. Ushqimet voluminoze janë esenciale për funksionim adekuat të rumenit. Rekomandohet që lopët të ushqehen me ushqime fibroze dhe me përmbajtje të vogël të energjisë. Një racion i mirë konsiston në 4 kg të lëndës së thatë ditore nga silazhi i barit të kualitetit të mirë së bashku me 6 kg kashtë gjatë muajit të parë dhe 6.5 kg të lëndës ditore të silazhes së barit dhe kashtë sipas dëshirës në muajin e dytë të periudhës së tharjes. Pak para pjelljes (10 ditë), lopët duhet të përgatiten për prodhimin e qumështit.


duke e rritur nivelin e ushqimit. Ushqimet voluminoze në racion nuk duhet të ndërrohen me ushqime tjera voluminoze pas pjelljes. Gradualisht rritet sasia e koncentrateve për 2 kg në ditë. Pas pjelljes, sasia e koncentratit duhet të rritet gradualisht ne përputhje me pritjet e prodhimit të qumështit.

KOHA E PERIUDHËS SE THARJES

Ndikimi i kohës së tharjes në prodhimtarinë e qumështit në laktacionin tjetër	
Ditët e tharjes në bazë të grupeve	Diferenca e prodhimit të qumështit, litër qumësht
5-20	- 584.7
21-30	- 285.3
31-40	- 70.8
41-50	+85.7
51-60	+ 135.2
61-70	+ 142
71-80	+ 72.1
81-90	+ 28.6
Përtej 90	+ 48.5

Ndërrimi i ushqimit

- Mos të ndërrohet ushqimi shpejt
- Nga largimi i një ushqimi në racion, mikroflora e rumenit do të ndryshoj brenda 3 dite
- Nëse në racion e fusim një ushqim te ri, mikroflorës së rumenit i duhen së paku 20 – 30 ditë për krijimin e baktereve special për tretjen e ushqimit te ri.



Rregullat e ushqimit

- Çdo ushqim/komponent për çdo ditë
- Ndërrimi i racionit është stres për kafshët
- Është mirë që ushqimi të përzihet në mënyrë që kafsha mos ti përzgjedh gjatë marrjes
- Ne çdo kohë lopa duhet të ketë qasje në ushqim dhe ujë

VLERSIMI I RUMENTI

Vlerësuesi i rumenit duhet të qëndroj në anën e majtë të lopës. Nga kjo anë mund të shihet gropa e rumenit, në mes të brinjës së fundit dhe ashtit të kërdhokullës (iliumi)

Shkalla 1.

Gropa e rumenit është shumë e zbrazët. Mbrapa brinjës së fundit, gropa e rumenit është shumë e theksuar. Gropa e rumenit ka formën e trekëndëshit kur te shikohet nga ana e majtë. Lopët të cilat kanë këtë shkallë tregojnë se nuk kanë konsumuar ushqim për disa ore apo gjate gjithë ditës



Shkalla 2.

Gropa e rumenit ende është e zbrazet dhe ka formën e trekëndëshit. Kjo shkallë e rumenit është e pranueshme për lopët menjëherë pas pjelljes në javën e parë. Duhet të siguroni që kjo gjendje të ndryshoj pas javës së parë të pjelljes



Shkalla 3.

Dallimi ne mes ashtit te kërdhokullës dhe brinjës se fundit është me i vogël se sa gjerësia e një dore. Gropa e rumenit nuk e ka formën e trekëndëshit. Kjo shkallë është ideale për lopët ne mes te laktacionit dhe me prodhimtari te lart. Marrja e ushqimit është e mjaftueshme



Shkalla 4.

Gropa e rumenit është e mbushur mirë dhe nuk vërehet shumë brinja e fundit dhe ashti i kërdhokullës. Kjo shkallë është ideale për lopët në fundë të lakatacionit dhe në tharje.




Shkalla 5.

Rumeni është plotësisht i mbushur dhe nuk vërehen brinja e fundit dhe ashti i kërdhokullës. Kjo shkallë është ideale për lopët në tharje.




A SHFRYTËZOHET I GJITHË RACIONI?



VLERËSIMI I BAJGËS


Shkalla 1.

Bajga është shume e holle dhe nuk duket si bajge. Lopët te cilat janë te infektuara apo me sëmundje metabolike kane këtë lloj bajge. Kjo bajge nuk është e pranueshme



Shkalla 2.

Bajga është pak me e trashe se ne shkallen e 1. Struktura e bajges munde te duket. Kur bajgabjer ne dysHEME ajo shpërndahet. Kjo shkalle e tregon se racioni nuk është I balancuar apo lopët kane konsumuar ushqim te gjelbër. Kjo shkalle është pranueshme për lopët me prodhimtari te lart.



Shkalla 3

Bajga është më e trashë dhe nuk shpërndahet lehtë kur të bjer në dysHEME. Bajga në dysHEME të pastër është rreth 2 cm e trashë. Kjo shkallë është ideale për lopët me prodhimtari të larte.




Shkalla 4.

Bajga është shumë e trash dhe e forte. Bajga në dysHEME nuk shpërndahet dhe merr formën e rrethit. Kjo shkalle nuk është e pranueshme për lopët në laktacion, për lopët në tharje dhe mështjerrat është ideale.



Shkalla 5.


Bajga është shumë e trash se sa shkalla e 4. Këtë shkallë shpesh e hasim tek lopët në tharje dhe mështjerrat. Sidoqoftë racioni duhet të ndryshohet dhe bajga te jetë në shkallen e 4



VLERËSIMI I BAJGËS ME ANË TË PREKJES DHE DUKJES


Shkalla 1

Bajga është pak e shkëlqyeshme dhe nuk ka grimca të dukshme në dysHEME. Bajga duket e butë, homogjene, gjatë shtrydhjes me dorë nuk ndihen grimcat e ushqimit. Kjo shkallë është ideale për lopët në laktacion.



Shkalla 2.

Bajga është me pak shkëlqyese se sa në shkallën e 1 dhe shihen disa grimca në dysHEME. Bajga është e butë por vërehen disa grimca gjatë shtrydhjes me dorë. Këto grimca janë të vogla, pjesërisht të pa tretshme. Kjo shkallë është e pranueshme për lopët në laktacion dhe në tharje



Shkalla 3.

Bajga është më pak e shkëlqyeshme dhe vërehen grimcat në dysHEME. Bajga nuk duket e butë dhe nuk është homogjene. Një pjesë e ujit largohet kur e shtrydhim, ndërsa disa grimca mbetin në dorë. Grimcat nga ushqimi voluminoz dhe koncentratit mbetin kur dora të hapet. Kjo shkallë është e pranueshme për lopët në tharje dhe mështjerrat por jo për lopët në laktacion.



Shkalla 4.

Bajga është pa shkëlqim. Fibrat dhe grimcat tjera nga ushqimi janë të dukshme në dysHEME. Bajga duket e vrazhdë dhe uji mund të largohet kur e shtrydhim me dorë, ndërsa grimcat janë prezentë. Pas apjes së dorës, grimcat më të mëdha se 2cm mbesin në shuplaken e dorës. Ky racion duhet të rishikohet.



Shkalla 5

Bajga është pa shkëlqim. Te gjitha grimcat e ushqimit të pa tretura janë të dukshme në dysHEME. Bajga është e forte. Pas shtrydhjes, në shuplaken e dorës shihen te gjitha grimcat e ushqimit të pa tretura. Ky racion duhet të ndryshohet.

